



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01- Nr- 016-33151

Më datë 10.06.2025

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të nenit 85, lidhur me nenin 44 dhe 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016" e konform nenit 10 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019", e në zbatim të nenit 33, pika 1, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 30, dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **PEZULLOHEN-** të gjitha procedurat të cilat janë duke u zhvilluar lidhur me dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nga dita kur Presidentja e Republikës së Kosovës i ka shpallur zgjedhjet lokale (09.06.2025) deri në konstituimin e organeve të reja të Komunës pas zgjedhjeve lokale.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për shërbimin pronësor juridike dhe kadastër dhe komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Ky vendim hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohet:
DSHPJK-ja
Komisioni
Arkiva